

AGJENDA

INVENTARI I QEVERISJES SË ETF: TË MËSOJMË NGA
PËRVOJA E SHQIPËRISË, JORDANISË, KAZAKISTANIT,
MOLDAVISË DHE UZBEKISTANIT

TAKIM ONLINE

17 NËNTOR 2021, 10.00 CET

PËRMBLEDHJE

Inventari i Qeverisjes së Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) të ETF 4.0 është një instrument metodologjik *novator* për të vlerësuar sa të gatshme janë institucionet për të përmbushur prioritetet e politikave në sektorin e AFP-së dhe të aftësive.

Ky Inventar ndihmon për të informuar politikëbërësit se si funksionon sistemi i aftësive dhe AFP-së. Ai trajton funksionet kryesore të aftësive dhe qeverisjes së AFP-së dhe fokusohet në arkitekturat institucionale, sistemin operacional dhe performancën e tyre. Pikërisht në këtë kontekst do të vlerësohen pikëpamjet, opinionet dhe përvojat e aktorëve kryesorë të qeverisjes së AFP-së dhe aftësive - të përfshirë në këtë motor - të cilat janë çelësi për të ndërtuar një tablo institucionale dhe me shumë nivele.

Kuadri analitik i Inventarit është përdorur për pilotimin e një procesi të vetëvlerësimit të politikës së përgjithshme të AFP-së, menaxhimit, financimit dhe të sigurimit të cilësisë (QA) të sistemit. Për të kuptuar nëse qeverisja e sistemit të AFP-së mbështet përmbushjen e objektivave të politikave, Inventari u zbatua në vitin 2020 në pesë vende partnere të ETF-së: Shqipëri, Jordani, Kazakistan, Moldavi dhe Uzbekistan.

Inventari i Qeverisjes së AFP-së të ETF 4.0 mbështetet në reagimet dhe pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë në AFP dhe në agjendën e aftësive: ministritë, organet qeveritare këshilluese të AFP-së, punëdhënësit, sindikatat, institucionet e AFP-së dhe ekspertët kryesorë kombëtarë. Analiza dhe vetëvlerësimi bazohen në 7 funksionet kryesore të qeverisjes së sistemit të AFP-së:

- *Formulimi dhe zbatimi i kuadrit të përgjithshëm të politikave, përfshirë instrumentet strategjike të politikave.*
- *Ofrimi i kuadrit ligjor dhe rregullator.*
- *Menaxhimi i AFP-së dhe rrjeteve të ofruesve të aftësive.*
- *Përafrimi dhe koordinimi i marrëveshjeve financiare.*
- *Menaxhimi i partneriteteve publike-private (PPP) për zhvillimin e AFP-së dhe aftësive.*
- *Monitorimi, vlerësimi dhe rishikimi i politikave të AFP-së dhe aftësive, duke përfshirë kërkimin dhe zhvillimin.*
- *Menaxhimi i sistemeve të informacionit, duke përfshirë ofrimin e informacioneve dhe të dhënave statistikore.*

Për të shkëmbyer përvojën e 5 vendeve që kanë zbatuar Instrumentin e Qeverisjes së ETF-së në vitin 2020, **Fondacioni Evropian i Trajnimit** do të organizojë një diskutim online më **17 nëntor 2021 nga ora 10.00 deri në 12.45 CET**. Ky takim do të ofrojë një mundësi për të diskutuar gjetjet dhe për të reflektuar së bashku se si është zbatuar kuadri metodologjik 4.0 për të vlerësuar qeverisjen e aftësive dhe Arsimin dhe Formimin Profesional.

E MËRKURË, 17 NËNTOR 2021

Moderator: Siria Taurelli, ETF GOV

TORINO (CET):	Përmbajtja
09:45 – 10:00	Hapet lidhja në internet për pjesëmarrësit
10:00 – 10:15	Fjala e Mirëseardhjes dhe Hyrje <i>Nga Z. Hugues Moussy, Drejtor i Njesisë së Performancës dhe Vlerësimit të Sistemeve, Departamenti i Qendrës së Njohurive, ETF, dhe Zj. Emmanuelle Roure, Zyrtar i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ENP dhe koordinator i UfM, Drejtorja e Përgjithshme për Punësimin, Çështjet Sociale dhe Përfshirjen, Komisioni Evropian</i>
10:15 - 10:30	Inventari i Qeverisjes së AFP-së të ETF 4.0: metodologjia dhe ushtrimi i zbatuar në vitin 2020 , nga Z. José Manuel Galvin Arribas, ETF
10:30 –11:10	Pikat kryesore nga Inventari i Qeverisjes së AFP-së të ETF 4.0 në vendet pjesëmarrëse: Shqipëri, Jordani, Kazakistan, Moldavi dhe Uzbekistan <i>Zj. Margareta Nikolovska, ETF</i> Diskutime me përfaqësuesit e shteteve • Z. Silviu Gîncu, Drejtor i Departamentit të AFP-së, Ministria e Arsimit, Kulturës dhe Kërkimit, Republika e Moldavisë • Prof. Qais Alsafasfeh, Komisioni për Zhvillimin e Aftësive Teknike dhe Profesionale, Jordani <i>Moderator: Z. Mounir Baati, ETF</i>
11:10 –11:20	Pushim për çaj & kafe
11:20 – 12:10	Vlerësimi i qeverisjes së AFP-së: analiza ndërvendore Çfarë mësimesh po mësojmë nga gjetjet? <i>Nga Z. Aram Avagyan, ekspert i ETF</i> Diskutime me përfaqësuesit e shteteve • Zj. Elira Demiraj, Drejtore e Përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Shqipëri • Zj. Rashida Shaikenova, Drejtore e Shoqatës së Turizmit të Kazakistanit • Zj. Feruza Rashidova, Eksperte për institucionet e AFPT-së, Uzbekistan <i>Moderator: Z. Vincent McBride, ETF</i>
12:10 – 12:20	Reflektim mbi rezultatet kryesore të diskutimit (nga World Cloud në Mentimeter)
12:20 - 12:40	Diskutim i hapur dhe fjala përmbyllëse <i>Zj. Siria Taurelli, ETF</i>